



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1802/19 Prot.

Tiranë, më 14.07 2023

V E N D I M

Nr. 85 dt. 14.07 2023

**“PËR
MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TË FUSHAVE DHE NËNFUSHAVE TË APLIKIMIT
PËR APLIKIMIN E KANDIDATËVE PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË TRETË
“DOKTORATË” NË FUSHËN “AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI” DHE TË
KRITEREVE PREFERENCIALE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE PËR
PROGRAMIN E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË FVFR PËR VITIN
AKADEMIK 2022-2023”**

Mbështetur në nenet 35, 38, 77 paragrafi 4 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, në nenin 20, 76 të Statutit të UST-së, në nenin 7 dhe 64 të Rregullores së UST-së, në nenin 12 të Rregullores për Organizimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë “Doktoratë” në UST, e ndryshuar si dhe mbështetur në Vendimin nr.17 datë 14.07.2023 të Komisionit të Doktoraturave, pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Senati Akademik në datën 14.07.2023,

V E N D O S I :

1. Miratimin përfundimtar të fushave dhe nënfushave të aplikimit për aplikimin e kandidatëve për programin e ciklit të tretë “doktoratë” në fushën “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti” dhe të kritereve preferenciale për pranimin e kandidatëve për programin e ciklit të tretë “Doktoratë” në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, në UST, për vitin akademik 2022-2023” (sipas dokumentit bashkëngjitur vendimit).
2. Ky vendim ti përcillet për njohje dhe zbatim Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA

